

VENDIM
Nr.410, datë 8.6.2011

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË GODINËS SË ISH-NDËRMARRJES SË
PRODHIMIT ARTIZANAL (NPA), SHKOZET, DURRËS, FAMILJEVE TË
SHPRONËSUARA NË ZONËN E PORTO-ROMANOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe të neneve 3 pika 2, e 7 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, pa kundërshtim, të një pjese të mjediseve të ish-Ndërmarrjes së Prodhimit Artizanal (NPA), në administrim të bashkisë Durrës, të përshtatur sipas marrëveshjes për ambiente banimi për familjet e shpërngulura nga zona e Porto-Romanos, pronë e shtetit shqiptar, në pronësi private të banorëve të shpërngulur, sipas listës që i bashkëlidhet aneksit 1 dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, në përmbushje të detyrimit të shtetit shqiptar, të caktuar sipas pikës 2, shkronja (b)“i”, të shtojcës së marrëveshjes së kredisë për zhvillim nr.4038, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Menaxhimi i integruar dhe pastrimi i zonës bregdetare”.

2. Ngarkohet bashkia Durrës të depozitojë pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Durrës, dokumentacionin e nevojshëm, teknik dhe ligjor, të kalimit të një pjese të mjediseve të ish-Ndërmarrjes së Prodhimit Artizanal (NPA) sipas pikës 1 të këtij vendimi, për regjistrimin e këtij dokumentacioni dhe pajisjen e qytetarëve të caktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me aktin e pronësisë së ambientit të ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha